



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Istog
Skupština Opštine Istok
Municipal Assembly Istog

Komitetit për Politikë dhe Financa/Komitet za Politiku i Financije/ Policy and Finance Committee

24	Procesverbal
Tipi i mbledhjes:	Mbledhje e rregullt e KPF-së
Data e mbajtjes:	24.01.2020, në ora 10:00.
Mbledhjen e kryesoi:	Qaush Balaj, Kryesuesi i Kuvendit
Procesmbajtës:	Vjosa Hysenaj, Zyrtarë e Lart për Punë Profesionale
Pjesëmarrës anëtarët e KPF-së	Zenel Shatri, Besa Ferati, Haki Podrimaj, Eliot Kukiqi, Ajshe Metaj dhe Ardita Idrizaj
Mungojnë:	
Pjesëmarrës të tjerë:	Nënkryetari i Komunës z. Agim Ademaj, Denë Qeta, Osmon Sadikaj, Hysni Maxharri, Drin Sadikaj, Lulzim Shoshi, Jasliar Blakaj, Enver Rugova, zekie Sutaj, Ardon Arifaj, Jeta Balaj-Imeraj Hysen Pelaj.
Rendi i ditës:	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, 2. Shqyrtimi i raportit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2019. 3. Raporti i punë së KKSBB-së për vitin 2019 4. Shqyrtimi i raportit të punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2019. 5. Shqyrtimi i Raportit financiar për tremujorin e katër, tetor-dhjetor 2019. 	
Diskutimet:	
<p>Kryesuesi z.Qaush Balaj, përshëndeti të pranishmit, kushtet janë plotësuar për mbajtjen e kësaj mbledhje. Hapi punimet për këtë mbledhje me pikat e rendit të ditës të parapara për këtë mbledhje. Kryesuesi - hedh në miratim kush rendin e ditës Miratohet një zëri.</p>	
Vendimet:	
Miratohet njëzëri rendi i ditës, me këto ndryshime të lartcekura.	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 1.	
Diskutimet:	
<p>Kryesuesi, vazhdojmë më pikën e parë të rendit të ditës: Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, materialin e keni pasur dhe keni mundur ta analizoni.</p> <p>Zenel Shatri - përshëndet të gjithë të pranishmit, ka vërejtje në procesverbal nuk është shënuar i gjithë fjalimi im, kamë folur shumë dhe me janë shkruar vete, dy rreshta.</p> <p>Kryesuesi - a ka dikush tjetër diçka.</p> <p>Pasi që diskutime tjera nuk pat hedh në miratim.</p>	
Vendimet:	
Miratohet njëzëri procesverbali nga mbledhja e kaluar, me vërejtje.	
Personat përgjegjës për zbatim:	
Afati për zbatim:	
Shqyrtimi i pikës 2.	
Diskutimet:	
<p>Kryesuesi, vazhdojmë më pikën e dytë të rendit të ditës: 2. Shqyrtimi i raportit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2019, raportin e keni pasur me material dhe keni pasur mundësi ta analizoni, raporti është ky, nëse ka dikush diçka rreth raportit le të urdhëroj.</p> <p>Pasi që diskutime nuk ka atehere kush është që t'i rekomadohet KK-së për shqyrtim:</p> <p>Unanim miratohet nga anëtarët e KPF-së.</p>	
Vendimet:	
Pasi që vërejte dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanim kalon: raportin e punës së Kuvendit Komunal për vitin 2019, dhe të njëjtin ia kalohet KK-së për shqyrtim.	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 3.	
<p>Kryesuesi, vazhdojmë më pikën e tretë të rendit të ditës: Raporti i punës së KKSB-së për vitin 2019. Fjalën ia kalon Nënkryetarit</p> <p>Nënkryetari - prezenton dhe sqaron Raportin e punës së KKSB-së për vitin 2019,</p> <p>Ajshe Metaj - ne e kemi pasur në muajin e kaluar që për muajin shkurt të diskutohet për qent endacak KKSB-ja. Të diskutohet për senzibilizimin e të rinjëve në qështjen e narkotikëve.</p> <p>Eliot Kukiqi - temat po shihen që të gjitha janë diskutuar është raport i mirë.</p> <p>Haki Podrimaj - të gjitha temat që kanë qenë në planë po shihen që janë diskutuar , është planë i mirë dhe do të jetë me i mirë për vitin 2020.</p> <p>Kryesuesi - Hedhë në votim Raportin e punës së KKSB-së për vitin 2019.</p> <p>Nga anëtarët e KPF-së miratohet unanim,</p>	
Diskutimet:	
Vendimet:	
Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF njëzëri rekomandon: Raportin e punës së KKSB-së për vitin 2019, si dhe i njëjti i kalohet KK-së për shqyrtim.	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 4.	
Diskutimet:	
<p>Kryesuesi, po vazhdojmë më pikën e katërt e rendit të ditës: Shqyrtimi i raportit të punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2019.</p> <p>Nënkryetari – bënë prezantimin dhe sqarimin e Raportit të punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2019.</p> <p>Kryesuesi pasi që diskutime nuk tjera nuk ka hedh ne votim, Në menyerë unanime nga anëtarët e rekomandohet ti kalohet KK.</p>	
Vendimet:	
<p>Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF njëzëri rekomandon: Raportin e punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2019, dhe të njëjtin ia kalohet Kuvendit të komunës-së për shqyrtim.</p>	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 5.	
Diskutimet:	
<p>Kryesuesi, po vazhdojmë më pikën e pestë e rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit financiar për tremujorin e katër, tetor-dhjetor 2019, fjalën ja kalon z. Osmon Sadikaj.</p> <p>Osmon Sadikaj, Zyrtar Kryesor Financiar – prezanton dhe sqaron Raportin financiar për tremujorin e katërt tetor-dhjetor për vitin 2019.</p> <p>Eliot Kukiqi – pse mjetet e alokuara nuk janë shpenzuar.</p> <p>Osmon Sadikaj – raportin e keni dhe e shihni vetëm një sqarim këtu, këto mjete kanë mbetur për arsye se disa projekte nuk kanë filluar fare, disa nga këto mjete janë për shkak të diferencave në projekte projekti është planifikuar me shtrenjtë ndërsa operatori ka jep ofertën me të lirë dhe ka mbetje aty, mundësinë për ti rialokuar këto mjete nuk e kemi pasur.</p> <p>Zenel Shatri – sa përqind nuk janë realizuar kapitalet.</p> <p>Osmon Sadikaj – 11 % nuk janë shpenzuar nga kapitalet.</p> <p>Haki Podrimaj – zyrtari na tha se për paga janë mbetur mbi 100 mijë euro, e arsyetoj deri dikund në bazë të ligjeve qe na u janë kthyes pas Gjykata Kushtetuese ato kanë qen dy konkurse të cilat janë kthye pas, po mendoj se edhe me këto dy konkurse nuk kish mundur të plotësohet ky kriter me gjithë këto mjete që kanë mbetur. Kamë edhe një pyetje tjetër, me numra të grandet qeveritare jemi mirë po pajtona, sa ju kujtohet në tremujorsh e kemi ngrit këtë çështje se nuk është realizu buxheti, tash me numra ka shkuar mirë. Unë pyesë pasi vetë kamë qenë në teren dhe disa inspektive disa punë që i kom pa nuk jam i kënaqur me punën të cilat janë kryere me cilësi, unë nuk jam i kënaqur me punën qe po bëhet nuk e di ekzekutivi a është i kënaqur. Kush është përgjegjës le të mbanë barrenë, unë si këshilltar që jam nuk jam i kënaqur me disa cilësi të punëve të cilat janë krye në teren. Në tremujorshin e tretë e kemi ngrit këtë çështje qe kemi thanë shumë në shpejtësi po kryhen punët mirë po cilësi nuk ka.</p> <p>Nënkryetari - konstatimi që thatë qëndron jo vetëm në komunën ton por në përgjithësi në të gjitha komuna me intensitet m të madhe, tani shkaqet është mirë me i thanë se tana duhet të jenë vërejtje apo dikush duhet të merret me të to që të bisedohet të diskutohet të rregullohen edhe ligjet, pasi që mendoj se është problem i madhe me ligjet aktuale që janë edhe zbatimin e tyre janë procedura të</p>	

prokurimit shumë të komplikuar, që po thotë kryetari boll fort jemi mundu me i nejtë gati sivjet por prape jemi vonuar, janë afatet në ankesa, tenderët, ivazioni i madhe i kompanive gjendja jo e mirë ekonomike i shtyn edhe ata të marrin hapa në ankesa tu tentu, procedurat e prokurimit, por sido që të jetë. Prape po them boll po tentojmë po aq janë procedurat e koklavitura telashe me u përmirësua diçka, kjo po përsëritet për çdo vite jo vetëm në komunën tonë po në përgjithësi. Të gjitha organizatat buxhetore duke i përfshirë edhe ministrit. Duhet munduar që të rregullohen pak këto procedura po janë të gjata, por duhet të jenë të kujdesshëm edhe drejtoret edhe ne në punimin e letrave që të mos kemi ankesa është e pamundur spo them secili tender por shumica e tyre kanë paq ankesa, po ashtu OSHP-ja ka pasur vonesa që kemi pritur me nga një muaj deri e ka kthyer përgjigjen këto janë ato probleme të cilat po ballafaqohen të gjitha komunat.

Të cilësia e projekteve edhe këtu kemi probleme ne e kemi një firmë të kontraktuar që është shpall me tender është kontrakti për mbikëqyrjen e punimeve tu mos e hjek përgjegjësia nga ne këto janë projektet në komunën tonë, vlerësimin ajo kompani është ligjërish e obliguar ta përcjellë, e sa është ajo korrekte e sa është e sinqerte aty po kemi probleme, kur po vjen puna me i leshu paret , po e ki procesverbalin prej firmës të nënshkruar paret po duhet me i pagu, edhe pse ne po i kemi edhe komisionet tona nga drejtorit përkatëse, por vetëm nënshkrimi i firmës kontraktuese i askujt tjetër nuk vlen dhe këtu po kemi probleme, me mirë me i pas projektet me emra dhe me ju drejta firmës që ka përgjegjësi ose me ju drejta gjykatëse që të jetë përgjegjëse ajo firmë për punën që është pranë dhe nuk është krye mirë këtu janë problemet me projekte.

Osmon Sadikaj - ato dhe disa konkurse tjera kanë bërë që të mbesin këto mjete në suficit. Mjetet po harxhohen në fund të vitit për shkak së tenderët po dalin në korrik dhe po ka probleme me procedurat e prokurimit, dhe pa qenë projekti detal nuk po mund të shpallim tenderin, për të punuar projekte detale siç po punojmë ne at duhet të paguhet 20 apo 30 mijë euro dhe krejt buxheti na shkon në punimin e projekteve, ky është realiteti. Ne nuk kemi zyre projektuese në komunë.

Zenel Shatri - nuk dua të lëshohem në detale po me vjen mirë që Nënkryetari në emër të ekzekutivit po i pranon do sende, që unë do ti përsëris edhe një here që i kom thanë edhe në tremujorin e tretë ku ka qenë shfrytëzimi i këtyre mjeteve kapitale ka qenë dikundë 27% për mu është shumë brengosësë dhe shumë diskutabile si 60% ku për dy muaj ditë nga tetori e deri tani me u shfrytëzu 60% të mjeteve e me mbet vetëm 10% ndërsa 20% për nënte muaj për mu është e pa kuptimtë arsyet i dimi ne jemi që me i analizu dhe me u mundu me i përmirësua me drejtoritë e me krejt ne si këshilltar si këshillëdhënës që jemi në komune dhe anëtar të KPF-së, mendoj që ka vend për kritika në çdo drejtorat por unë do të them global.

Neglizhenca e drejtorve sepse alokimi i parë është bërë dikund në muajin marse, nga marsi e deri në muajin tetor buxheti është shpenzuar vetëm 27% dhe prej tetorit 60% aty ekziston një gabim, dukund është një gabim që mendoj që është neglizhenca e drejtorve në përgjithësi mos projektimi bërja e projekteve me kohë, mos shpallja e tenderëve. Askënd nuk po dua të akuzoj po dua vetëm të jap vërejtje ishallas nuk përsëritet vitet e ardhshme për 6 mujë dit 30% dhe për dy mujë dit 60% , arsyetime kemi bollë ne të gjithë jemi intelektual të gjithë i shohim gjërat ka vend për kritika për të gjithë edhe për ne në KPF ndonjëherë dhe për të gjithë këshilltaret komunal. Nuk jam i kënaqur me punën e drejtorive me shfrytëzimin e kapaciteteve, deficiti, konkurset, ministria ne nuk kemi çka me bë se nuk i ka lejuar ne si komunë duhet të bëjmë atë që mund të bëjmë ne ajo që nuk kemi mundësi është diçka tjetër. Tenderët në shpejtësi ne të gjitha e dimë si bëhen aty nuk ka cilësi vetëm në nguti të gjitha punët, krejt këto i dimi unë kisha apelu që ketë vite ti rrimë gati të gjithë duke filluar nga ekzekutivi drejtorat ti bëjmë tenderët me kohë ti jetë shpallja me kohë.

Nuk jam i kënaqur me raportin, nuk jam i kënaqur me punën në përgjithësi, ka vend për përmirësim, Apeloj që këtë vit ti rrimë gatshëm si të alokohen parat ti harxhojmë me kohë. Pastaj ligjin për punësim ta shfrytëzojmë mirë, është gjynah me u kthye 100 mijë euro në suficit tu pas vende të punës njerëzit tu prit nga të gjitha profesionet. Sivjet është dashur ti qelin sytë me mirë me punu më shumë në mënyre që mos me mbetur.

Nënkryetari - të kuptoj drejtë doktor në këtë frymë fola edhe unë kemi vërejtje krejt këto gjëra munden thjeshtë me u pa ma në detale, ka projekt që ka fillu të punohet në korrikë është punuat në korrikë dhe gushtë ndërsa pagesa hynë në fazën e fundit në finale në muajin tetor a nëntor për shkak së nuk mundesh me ja dhen parat pa e përfundu punën kompletë pa e pru raportin përfundimtar të pranimit të punës ka shumë elemente me i studioju mirë sigurisht që na dërgojnë përpara në frymën e kësaj qe e thatë ju mund të jemi me të kujdesshëm ka vërejtje sa të duash, po nuk mund të thuash tash 60% e buxhetit është shfrytëzu në tremujorin e katërt, edhe pse me letra qashtu po del po puna ka filluar në korrik me u punuare, mirë po nuk ke mundur tua japsh parat në gushtë pa u përfundu puna ka shumë elemente që duhet me i analizua duhet me i studiuar a qëndron kjo vërejtje normalisht ekzekutivi duhet të jete me i kujdesshëm tenderët të përgatiten me mirë

Zenel Shatri - atyre kompanive që ju jepet tenderi tu epet edhe afati i kryerjes së punëve, dhe nëse nuk përfundon punën në afat të dënohet kompania dhe të i merret tenderit dhe ti epet dikujt tjetër ndonjë kompanie tjetër.

Ajshe Metaj - as unë spo dua të bëj detale shumë pajtona plotësash me z. Podrimaj kolegen që faktikisht punet që janë kry dhe qe i kemi kry konkretisht të shtrimi i rrugëve, sa respektohen standardet, kushë i përcakton ato standarte sa duhet të jetë rruga e gjanë apo e ngushtë, gjithashtu edhe për trotuare unë e kom pa rastin e trotuarit për Studenic shumë i ngushtët, qëllimin e kamë që komuna i kontraktun ata që ua ep punën po sa i menaxhon sepse ata nuk mund të krijojnë standarde vetë sa me thanë p.sh dialekti i trotuarit po ne duhet me kanë ata që ua epim punën e nuk po munden me jau caktu do e aty nuk po dihet a është me dije të komunës kur po janë ata zvogëlime ati ti bëjnë krye në veti kontraktuesit këtë nuk po e di po kom qef me dit, edhe cilësia e asfaltit nuk është askund, tash a duhet me e ndrru ju kontraktuesin a nuk duhet me denu atë që faktikisht është qështja kur don me i ba pagesat a me ja pranu projektin një komision prej ktuhit me kqyrë a është punuar mirë a jo, nëse nuk e ka bam ir me e ndeshku duhet me kerku llogari prej tije se ata mund të bëjn edhe me zi, konkretish po flas për rrugën që me ka ra për Orroberdë kjo rrugë është shtruar krejt vonë dhe është qa krejt asfalti.

Ardita Idrizaj - Rruga në fshatin Lubozhdë lagja "Januzaj" rruga e re sa është ndërtuar dhe menjëherë është dëmtuar dhe në fillim të rrugës është punuar shumë keq qe lidhet me rrugën kryesore Istog-Vrellë.

Enver Rugova - kompania e kontraktuar nga Komuna po e vlerëson që punët kanë përfunduar në rregull po e nënshkruajnë raportin dhe ne nuk kemi çka të bëjmë.

Haki Podrimaj - të përcillen kompetentet e ndërtimi që të punojnë mirë, ose të ndëshkohen kompanit.

Kryesuesi - kalojmë në piken tjetër

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejtje dhe diskutime, KPF njëzëri rekomandon: Shqyrtimi i Raportit financiar për tremujorin e katër, tetor-dhjetor 2019, dhe e njëjta i kalohet KK-së për shqyrtim.

Personat përgjegjës për zbatim:

Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
<p>Haki Podrimaj – Shqetësimi im është se në katër qendrat urbane të mjekësis familjare Banjë, Vrellë Gurrakoc dhe Rakosh të shtunave nuk ka nxemje,.</p> <p>Kryesisht në banjë është ankuar personeli që nuk ka nxemje dhe të shtunave stafi që punon nga ora 7 deri në ora 12 thonë që është shumë ftohtë, një mirëmbajtës është punësuar aty por të shtunave nuk shkon për të dhezur nxemjet.</p>	
<p>Kryesuesi, pasi që përfunduan pikat për këtë rend dite, falënderoj për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë dhe shpalli të mbyllura punimet për këtë mbledhje. †</p>	
Mbledhja përfundoj :	11:11